



BASHKIA MIRDITË

Çështjet kryesore:

Mirdita feston me Kosovën.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

Trajnimi i stafit në kuadër të projekteve.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë.

Promovimi i librit të studiuesit Ndriçim Kulla

Nxitja e politikave inovative për një fuqi punëtore më gjithëpërfshirëse dhe kujdes afatgjatë më të mirë.

Mirdita “Ekipi Volejbollit”.

Buletini i Muajit Shkurt 2025

28.02.2025

Mirdita feston me Kosovën.

Në kuadër të festimeve për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, artistët e Ansamblit Mirdita “Mjeshter i Madh” morën pjesë në një edicion të veçantë të emisionit “Ftohtë e Nxehtë - RTV21”, ku sollën një performancë me këngë dhe valle tradicionale. Performanca e ansamblit shërbeu si një simbol i lidhjes së thellë dhe bashkëpunimit kulturor mes Mirditës dhe Kosovës, duke afirmuar vlerat dhe traditat tona të përbashkëta.

Emisionin mund ta shikoni në linkun e mëposhtëm:
<https://youtu.be/CzTJFUUfX70>



Infrastruktura rrugore.

Siç është bërë e ditur më herët, në territorin e Bashkisë Mirditë po vijojnë punimet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Puna ka përfunduar me sukses në asfaltimin e rrugës së fshatit Jezull dhe të segmentit të rrugës së Repsit.

Pas asfaltimit, do të vazhdojë procesi i vendosjes së sinjalistikës rrugore që rruga të jetë plotësisht funksionale.

Gjithashtu, punimet vijojnë në qytetin Rrëshen dhe në rrugën Ndërfushaz-Ndërfanë për të vijuar me segmente në rrugën e fshatit Kodër-Rrëshen si dhe në qytetin Rubik .

Këto investime priten të përmirësojnë kushtet e lëvizjes dhe të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e zonës.




Foto nga segmenti rrugor Reps

Asfaltimi i rrugës së fshatit Jezull



“Nxitja e politikave inovative për një fuqi punëtore më gjithëpërfshirëse dhe kujdes afatgjatë më të mirë.”

Më 21 shkurt 2025 në Bashkinë Mirditë u zhvillua takimi i fillimit të projektit “Rritja e politikave inovative për një forcë punëtore më gjithëpërfshirëse dhe kujdes më të mirë afatgjatë në Bashkinë e Mirditës”.

Projekti është partneritet i Institutit Liberal të Tiranës Pashko me Bashkinë Mirditë.

Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës që synon integrimin në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive për vajzat, gratë, djemtë dhe burrat që përballen me kushte të pafavorshme punësimi.

Kjo nismë do të përqendrohet në forcimin e kapaciteteve individuale të këtyre grupeve të synuara, fuqizimin e instucioneve lokale për ofrimin e shërbimeve të integruara dhe nxitjen e një bashkëpunimi të fortë ndër-sektorial midis sektorit publik dhe privat.

Aktiviteti mbledhi përfaqësues nga PNUD, Zyra Rajonale e Punësimit Mirditë, Njësitë administrative, të rinjtë dhe grupet e pafavorizuara.



Trajnimi i stafit në kuadër të projekteve.

Me datë 10 shkurt 2025, u realizua trajnimi për stafin e Bashkisë Mirditë, me fokus dy projektet Mirdita - Junik dhe Effort, të programit ndërkufitar Shqipëri - Kosovë, asistencë financiare në kuadër të IPA, financuar nga Bashkimi European.

Ky trajnim kishte si qëllim njohjen e stafit me procedurat e nevojshme dhe metodat e raportimit, për të siguruar një përgatitje të plotë dhe zbatim të suksesshëm të projekteve.

Ekspertet që ofruan trajnimin ishin nga Sekretariati i Përbashkët Teknik (JTS) që monitoron thirrjet e Programit Ndërkufitar (CBC) Shqipëri-Kosovë dhe nga struktura e Ndërtimit të Institucioneve Ndërkufitare.



Promovimi i librit të studiuesit Ndrìçim Kulla.

Më 12 shkurt 2025, në qytetin e Rrëshenit, u promovua libri i studiuesit dhe publicistit Ndrìçim Kulla, i titulluar “Narkodiktatura Shqiptare në Oborrin e Europës”.

Ky libër trajton proceset politike dhe ekonomike në Shqipëri.

Promovimi tërhoqi vëmendjen e një audience të gjerë dhe u shoqërua me diskutime ndërmjet pjesëmarrësve dhe autorit.



Studiuesi dhe publicisti **NDRIÇIM KULLA** së bashku me Shtëpinë Botuese Plejad dhe Fondacionin për Liri dhe Demokraci, prezantojnë librin:

"NARKODIKTATURA SHQIPTARE NE OBORRIN E EUROPES



Projekti “Cool-Crafting”.

Në kuadër të projektit Cool-Crafting, i cili ka si qëllim krijimin e mundësive dhe lidhjeve të qëndrueshme midis zejeve tradicionale dhe turizmit, Help Albania ka organizuar një seri sesionesh informuese në qytetet Rubik dhe Rrëshen.

Këto sesione janë të orientuara kryesisht për të rinjtë dhe gratë nga Mirdita, të cilët janë të interesuar të zhvillojnë aftësitë e tyre në zanate tradicionale dhe të krijojnë mundësi për një karrierë të qëndrueshme në këtë fushë.

Të gjithë ata që janë të interesuar të bëhen pjesë e këtij projekti dhe të mësojnë një zanat të ri, mund të kontaktojnë për më shumë informacion:

- Telefon: 0695726762
- Email: info-alb@help-ev.de



Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë për muajin Shkurt

Këshilli Bashkiak Mirditë ka zhvilluar mbledhjen e muajit Shkurt me datë 24.02.2025, ku u miratuan disa nga projekt-vendimet e rendit të ditës.



Mirdita-Ekipi i Volejbollit

Ekipi i volejbollit të Mirditës ka regjistruar një fitore të rëndësishme në ndeshjen e zhvilluar më 27 shkurt 2025 ndaj Elbasanit, duke e mundur këtë të fundit me rezultatin 3-0.

Ndeshja, e cila u zhvillua në Pallatin e Sportit "Arjana Arapi", ishte një shfaqje e shkëlqyer e skuadrës vendase, e cila tregoi forcë, disiplinë dhe bashkëpunim të shkëlqyer në fushë.

